

20180350583

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16 dhe 132/16), në nenin 11 paragrafi (1) pika 9) ndryshohet si vijon:

"9) bujqit individualë – detyrës të tatimit mbi fitim nga veprimtaria bujqësore të cilëve veprimtaria bujqësore u është profesion i vetëm (në tekstin e mëtejme: bujq individualë);".

Neni 2

Në nenin 31 paragrafi (2) fjalët: "bartësit e ekonomisë bujqësore familjare" zëvendësohen me fjalët: "bujqit individualë".

Neni 3

Në nenin 38 paragrafi (6) fjalët: "bartësit e ekonomisë bujqësore familjare" zëvendësohen me fjalët: "bujku individual".

Neni 4

Në nenin 61 paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Të drejtë në pension familjar pas vdekjes së prindit ka edhe fëmija me status të personit me invaliditet të përcaktuar sipas rregullave për mbrojtje sociale dhe rregullave për punësim të personave me invaliditet, pa marrë parasysh nëse ka qenë person i mbajtur nga i siguruari ose shfrytëzuesi i pensionit."

Pas paragrafit (5) shtohen dy paragrafë të rinj (6) dhe (7), si vijojnë:

"(6) Fëmijës me status të personit me invaliditet të përcaktuar sipas rregullave për mbrojtje sociale dhe rregullave për punësim të personave me invaliditet, i cili është shfrytëzues i pensionit familjar dhe themelon marrëdhënie të punës ose kryen veprimtari të pavarur sipas rregullave për punësim të personave me invaliditet, ndërsa sipas të cilës bazë ka sigurim të detyrueshëm social, i ndërpritet pagesa e pensionit familjar. Pas ndërprerjes së sigurimit të detyrueshëm social vazhdon pagesa e pensionit familjar.

(7) Fëmija me status të personit me invaliditet të përcaktuar sipas rregullave për mbrojtje sociale dhe rregullave për punësim të personave me invaliditet, i cili para vdekjes së prindit ka themeluar marrëdhënie të punës ose ka filluar të ushtrojë veprimtari të pavarur me sigurim të detyrueshëm social, ka të drejtë në pension familjar pas vdekjes së prindit dhe pushimit të marrëdhënies së punës ose ushtrimit të veprimtarisë së pavarur."

Neni 5

Në nenin 111 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Vendet e punës në të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohëzgjatje të zmadhuar, e të cilat nuk janë përfshirë në rregulloren nga neni 110 të këtij ligji, si dhe revizionin e atyre vendeve të punës, i përcakton Komisioni për revizion të vendeve të punës në të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohëzgjatje të zmadhuar. Revizioni bëhet më së voni në afat prej pesë vitesh nga dita e përcaktimit të vendeve të punës me stazh të sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar."

Paragrafët (3) dhe (4) ndryshohen si vijojnë:

"Përcaktimin e vendeve të punës me stazh të sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar, revizionin e atyre vendeve të punë dhe revizionin e vendeve të punës të përcaktuara sipas nenit 110 të këtij ligji, Komisioni nga paragrafi (1) të këtij neni e kryen në bazë të elaboratit për përcaktim të vendeve të punës me stazh të sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar, të përpiluar në pajtim me Metodologjinë nga paragrafi (4) të këtij neni.

Metodologjinë për përcaktim të normativave për përpilim të elaboratit për përcaktim të vendeve të punës me stazh të sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar, e miraton Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.“.

Paragrafi (5) shlyhet.

Paragrafi (6) bëhet paragraf (5).

Neni 6

Në nenin 125 paragrafi (4) pika 3) fjalët: "bartësi i ekonomisë bujqësore familjare" zëvendësohen me fjalët: "bujku individual".

Neni 7

Pas nenit 162 shtohet nen i ri 162-a, si vijon:

"Neni 162-a

(1) Në rast kur ka skaduar koha për të cilën është emëruar drejtori, ndërsa pas konkursit të shpallur publik nuk është bërë përzgjedhje e drejtorit, si dhe në rast të shkarkimit të drejtorit nga neni 162 të këtij ligji, Bordi drejtues miraton vendim për emërim të ushtruesit të detyrës drejtor deri në emërimin e drejtorit me konkurs të shpallur publik, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

(2) Për vendimin për emërim të ushtruesit të detyrës drejtor nga paragrafi (1) të këtij neni, pëlqim jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë.“.

Neni 8

Në nenin 187 paragrafi (1) pika 1) fjalët: "bartësit e ekonomisë bujqësore familjare" zëvendësohen me fjalët: "bujqit individualë".

Neni 9

Në nenin 199 paragrafi (1) pika 3 fjalët: "bartësit e ekonomisë bujqësore familjare" zëvendësohen me fjalët: "bujqit individualë".

Neni 10

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 15/13), neni 9 shlyhet.

Neni 11

Akti nënligjor miratimi i të cilit është përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 12

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 13

Procedurat e filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, e të cilat kanë të bëjnë me bartësit e ekonomisë bujqësore familjare në pajtim me dispozitat e nenit 11 paragrafi (1) pika 9, nenit 31 paragrafi (2), nenit 38 paragrafi (2), nenit 125 paragrafi (4) pika 3, nenit 187 paragrafi (1) pika 1 dhe nenit 199 pika 3 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16 dhe 132/16), do të përfundohen sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".